



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 18 , datë 01 .07. 2025

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
ELBASAN sh.a

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*" **(ligji nr. 8102)**, i ndryshuar; vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*" **(Vendim KKRR nr.539)**, i ndryshuar;

Komisioni Kombëtar Rregullator

Në mbledhjen e datës 01.07.2025 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a. me shkresën nr. 1496 prot. datë 28.06.2024, me lëndë "Kërkesë për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura" ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rishikimin e nivelit tarifar për shërbimet ujësjellës kanalizime sipas tabelës nr.1 të mëposhtme:

Tabela 1: Tarifat Aktuale dhe të Propozuara nga Shoqëria Rajonale UK Elbasan për vitet 2025-2027.

Njësitë	Kategoria e Klientëve		Zona e Shërbimit	
			Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara Vitet 2025-2027
A. Shërbimi i FU			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Elbasan	Njësia Elbasan	1. Klientë Familjarë	40	60
		2. Klientë Publik	130	130
		3. Klientë Privat	130	130
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë Familjarë	42	60
		2. Klientë Publik	100	130
		3. Klientë Privat	100	130
	Librazhd Rurale	1. Klientë Familjarë	26	60
		2. Klientë Publik	60	130
		3. Klientë Privat	60	130
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë Familjarë	32	60
		2. Klientë Publik	90	130
		3. Klientë Privat	90	130
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë Familjarë	38	60
		2. Klientë Publik	120	130
		3. Klientë Privat	120	130
Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë Familjarë	38	60
		2. Klientë Publik	120	130
		3. Klientë Privat	120	130
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë Familjarë	48	60
		2. Klientë Publik	120	130
		3. Klientë Privat	120	130
B. Shërbimi i KUN			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë Familjarë	9	15
		2. Klientë Publik	30	30
		3. Klientë Privat	30	30
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë Familjarë	15	15
		2. Klientë Publik	25	30
		3. Klientë Privat	26	30
	Librazhd Rurale	1. Klientë Familjarë	15	15
		2. Klientë Publik	-	30
		3. Klientë Privat	-	30
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë Familjarë	-	15
		2. Klientë Publik	-	30
		3. Klientë Privat	-	30
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë Familjarë	6	15
		2. Klientë Publik	6	30
		3. Klientë Privat	6	30

Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë Familjarë	-	15
		2. Klientë Publik	-	30
		3. Klientë Privat	-	30
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë Familjarë	12	15
		2. Klientë Publik	16	30
		3. Klientë Privat	16	30
D. Tarifë Fikse Shërbimi			Lek/muaj/ lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë Familjarë	200	200
		2. Klientë Publik	400	400
		3. Klientë Privat	400	400
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë Familjarë	100	200
		2. Klientë Publik	100	400
		3. Klientë Privat	100	400
	Librazhd Rurale	1. Klientë Familjarë	100	200
		2. Klientë Publik	100	400
		3. Klientë Privat	100	400
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë Familjarë	60	200
		2. Klientë Publik	150	400
		3. Klientë Privat	180	400
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë Familjarë	120	200
		2. Klientë Publik	120	400
		3. Klientë Privat	120	400
Njësia Cërrik *	Njësia Cërrik	1. Klientë Familjarë	120	200
		2. Klientë Publik	120	400
		3. Klientë Privat	120	400
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë Familjarë	100	200
		2. Klientë Publik	200	400
		3. Klientë Privat	200	400

* Tarifa të pa miratuara nga ERRU, por të vendosura sipas vendimeve të këshillave bashkiak përkatëse.

- Me vendimin nr. 41, datë 23.10.2024, “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Elbasan sh.a.”, Komisioni Kombëtar Rregullator vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të SHRUK Elbasan.
- Kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a, për vendosjen e nivelit të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021, i ndryshuar.
- Shoqëria Rajonale UK Elbasan aplikon tarifat e miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese sipas:
 - Vendimit të KKRR nr. 33, datë 11.05.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë ujësjellës Gramsh sh.a”;

- Vendimit të KKRR nr. 75, datë 19.10.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Librazhd Prrenjas sh.a”;
 - Vendimit të KKRR nr. 576, datë 02.12.2022 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Elbasan sh.a”;
 - Vendimit të KKRR nr. 119, datë 20.10.2020 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës kanalizime Peqin sh.a”.
5. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:
- a) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare dhe mbulimi mbi 100% i kostove operacionale;
 - b) Aplikimi për nivel të ri tarifor për shkak të rritjes së çmimeve të materialeve dhe pagës minimale ndër vite;
 - c) Përmirësim i cilësisë së shërbimeve të ofruara të FU dhe KUN si rezultat i investimeve të parashikuara;
 - d) Tarifatat e reja të propozuara synojnë edhe mbulimin e shpenzimeve të riparimeve për eliminimin e defekteve apo lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.
6. Gjatë procesit të analizës tekniko ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave të përcaktuar në Vendimin e KKRR nr. 539, datë 30.12.2021 i ndryshuar, ERRU ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit.
7. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare, janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Rajonale Elbasan sh.a e kriterëve të mëposhtme:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, i ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë sa i takon mbrojtjes së konsumatorëve nga çmimet monopol dhe mbrojtjen e interesave të tyre në lidhje me cilësinë, eficientë, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, sa i takon mos lejit të abuzimit me pozitën dominuese në treg, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve, pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes dhe të konkurrentëve të tjerë, pengesat në hyrje në tregun përkatës dhe konkurrencën potenciale;
 - c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar;
 - d) Kërkesave të VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

- e) Orientimin e tarifave drejt mbulimit të Kostove Operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;
 - f) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.
8. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU ka vendosur detyra për t'u realizuar nga UK Rajonale Elbasan sh.a:
- a. Ti kushtohet vëmendja e duhur për përmbylljen sa më parë instalimit të matësave në prodhim dhe atyre familjarë të parashikuar, për të gjithë klientët në zonën e shërbimit në mënyrë që të arrijë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesin e nivelit të matjes dhe uljen e humbjeve;
 - b. Të kryejë vlerësimin e “Ujit të Prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet me dhe pa ujëmatës;
 - c. Të mbajë aktive vazhdimisht Task-Forcën për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit dhe abuzimet kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale;
 - d. Të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të patur situatë reale mbi UPA dhe të merren masat dhe të bëhen korrigjimet përkatëse gjatë hartimit të Bilancit të Ujit për vitin 2024 dhe në vazhdim;
 - e. Shoqëria duhet të aplikojë për nivel të ri tarifar jo më vonë se muaji qershor 2027, duke qenë se periudha rregullatore do të jetë 2025-2027;
 - f. Të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara për të planifikuar prioritetet e investimeve në të ardhmen e afërt në mënyrë që të evitohet vjetërimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme, e cila lidhet ngushtësisht me strategjinë e zvogëlimit të humbjeve nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet në çarjet;
 - g. Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të paktën për vitin 2026, si një vit bazë që do të përdoret për aplikimin e radhës;
 - h. Të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar gjatë periudhës rregullatore, pra në vitet 2025-2027;
 - i. Me mbështetjen e Task Forcës të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit dhe asaj të përgjithshme duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si, monitorimi i klientëve, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesa bankare, pagesa online dhe deri ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë;

- j. Treguesi i efektivitetit të stafit që lidhet me një nga elementet e rëndësishëm të kostove të O&M duhet të justifikohet me argumenta mbështetëse. Për këtë duke hartuar urgjentisht një organogramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri;
- k. Ti kushtohet vëmendje e veçantë konsumit të energjisë në drejtim të monitorimit dhe kontrollit të ketyre kostove, duke i dhënë prioritet hartimit urgjent të një studimi mbi efikasitetin e energjisë me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie afatgjatë për energjinë.
9. Në mbledhjen e datës 04.06.2025 Komisioni Kombëtar Rregullator konkludoi mbi projektvendimin për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Referuar analizës tekniko - ekonomike, ERRU e gjen të justifikuar kërkesën e shoqërisë për ndryshimin e nivelit tarifar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria.
10. Me shkresën nr. 317/9, datë 10.06.2025, me lëndë “Mbi aplikimin për nivel të ri tarifar të shoqërisë Rajonale UK Elbasan”, ERRU ka përcjellë për komente projektvendimin e shoqëruar me relacionin përkatës pranë shoqërisë UK Rajonale Elbasan, AKUK, Autoritetit të Konkurrencës dhe bashkive Elbasan, Gramsh, Belsh, Cërrik, Peqin, për të cilën nuk është dërguar zyrtarisht asnjë koment.
11. Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me Vendim nr. 539, datë 30.12.2021 “*Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime*”, arrin në konkluzionin se sipas analizës së kryer, tarifat janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “*Për mbrojtjen e konkurrencës*”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “*Për mbrojtjen e konsumatorëve*”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 “*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*”, i ndryshuar, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a si më poshtë:

Tabela nr.2. Tarifat e miratuara nga ERRU për shoqërinë Rajonale UK Elbasan.

Njësité	Kategoria e Klientëve		Zona e Shërbimit	
			Tarifat Aktuale	Tarifat e Propozuara Vitet 2025-2027
A. Shërbimi i FU			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Elbasan	Njësia Elbasan	1. Klientë Familjarë	40	60
		2. Klientë Publik	130	130

		3. Klientë Privat	130	130
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë Familjarë	42	60
		2. Klientë Publik	100	130
		3. Klientë Privat	100	130
	Librazhd Rurale	1. Klientë Familjarë	26	60
		2. Klientë Publik	60	130
		3. Klientë Privat	60	130
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë Familjarë	32	60
		2. Klientë Publik	90	130
		3. Klientë Privat	90	130
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë Familjarë	38	60
		2. Klientë Publik	120	130
		3. Klientë Privat	120	130
Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë Familjarë	38	60
		2. Klientë Publik	120	130
		3. Klientë Privat	120	130
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë Familjarë	48	60
		2. Klientë Publik	120	130
		3. Klientë Privat	120	130
B. Shërbimi i KUN			Lek/m³	Lek/m³
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë Familjarë	9	15
		2. Klientë Publik	30	30
		3. Klientë Privat	30	30
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë Familjarë	15	15
		2. Klientë Publik	25	30
		3. Klientë Privat	26	30
	Librazhd Rurale	1. Klientë Familjarë	15	15
		2. Klientë Publik	-	30
		3. Klientë Privat	-	30
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë Familjarë	-	15
		2. Klientë Publik	-	30
		3. Klientë Privat	-	30
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë Familjarë	6	15
		2. Klientë Publik	6	30
		3. Klientë Privat	6	30
Njësia Cërrik*	Njësia Cërrik	1. Klientë Familjarë	-	15
		2. Klientë Publik	-	30
		3. Klientë Privat	-	30
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë Familjarë	12	15
		2. Klientë Publik	16	30
		3. Klientë Privat	16	30
D. Tarifë Fikse Shërbimi			Lek/muaj/ lidhje	Lek/muaj/lidhje
Njësia Elbasan	Elbasan	1. Klientë Familjarë	200	200
		2. Klientë Publik	400	400

		3. Klientë Privat	400	400
Njësia Librazhd	Librazhd Urbane	1. Klientë Familjarë	100	200
		2. Klientë Publik	100	400
		3. Klientë Privat	100	400
	Librazhd Rurale	1. Klientë Familjarë	100	200
		2. Klientë Publik	100	400
		3. Klientë Privat	100	400
Njësia Gramsh	Njësia Gramsh	1. Klientë Familjarë	60	200
		2. Klientë Publik	150	400
		3. Klientë Privat	180	400
Njësia Belsh*	Njësia Belsh	1. Klientë Familjarë	120	200
		2. Klientë Publik	120	400
		3. Klientë Privat	120	400
Njësia Cërrik *	Njësia Cërrik	1. Klientë Familjarë	120	200
		2. Klientë Publik	120	400
		3. Klientë Privat	120	400
Njësia Peqin	Njësia Peqin	1. Klientë Familjarë	100	200
		2. Klientë Publik	200	400
		3. Klientë Privat	200	400

2. Objektivat e Treguesve të Performancës në fund të vitit 2027 të vendosura nga ERRU janë:

Tabela nr.3: Objektivat e Treguesve të Performancës (TKPs)

TKP	Nr.	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Objektivat e vendosura nga ERRU në fund të Vitit 2027
Mbulimi me shërbim	1.1	Mbulimi me shërbimin e FU	%	80
	1.2	Mbulimi me shërbimin me KUN	%	55
TKP Teknike	2.1	Uji Pa të Ardhura	%	55
	3	Niveli i Matjes	%	85
	4	Vazhdimësia e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	20
	5.1	Efikasiteti i Energjisë për ujin	kWh/m ³	0.6
	6	Efienca e stafit	nr/nr/1000 banorë	1.5
Shërbimi ndaj klientit	7.1	Ankesat e Klientëve	%	14
	7.2	Ankesat e Klientëve që kanë marrë përgjigje	%	100
	7.3	Ankesat e Klientëve që kanë marrë zgjidhje	%	0.5
TKP Financiare	8.1	Norma Korrente e Arkëtimit	%	80
	8.2	Norma e Përgjithshme e Arkëtimit	%	105
	9.2	Mbulimi i Kostove O&M	%	85

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sh. a. do të jetë 0.77% e të ardhurave vjetore të parashikuara, nga aktiviteti i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
4. Vendimi i KKRR nr. 33, datë 11.05.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë për shoqërinë ujësjetllës Gramsh sh.a”; Vendimi i KKRR nr. 75, datë 19.10.2018 “Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjetllës kanalizime Librazhd Prrenjas sh a”; Vendimi i KKRR nr. 576, datë 02.12.2022 “Për miratimin e tarifave të shërbimit te furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjetllës kanalizime Elbasan sh.a”; Vendimi i KKRR nr. 119, datë 20.10.2020 “Për miratimin e tarifave të shërbimit te furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjetllës kanalizime Peqin sh.a”, shfuqizohen;
5. UK Rajonale Elbasan sh.a detyrohet të nënshkruajë kontratën “Për aplikimin e tarifave të miratuara nga ERRU dhe shlyerjen e pagesës rregullatore” brenda 30 ditëve nga data e njoftimit
6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 01.08.2025 dhe është i vlefshëm deri në 31.12.2027.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

GERTA LUBONJA

